Mesazhe për vaksinimin kundër COVID-19 për fëmijët nga 6 muaj deri në 5 vjeç

Këto mesazhe të shkurtra me fakte mund t'ju ndihmojnë të flisni për vaksinën kundër COVID-19 për fëmijët nga 6 muaj deri në 5 vjeç.

Fëmijët e vegjël mund të sëmuren rëndë nga COVID-19. Ata mund të përhapin virusin.

- COVID-19 mund të bëjë që fëmijët të sëmuren rëndë. Kjo mund të rezultojë potencialisht në shtrimin në spital, komplikime shëndetësore afatgjata, apo edhe vdekje. Dhjetëra mijëra fëmijë dhe adoleshentë me COVID-19 u është dashur të shtrohen në spital, dhe COVID i gjatë ndodh tek fëmijët.
- Fëmijët gjithashtu mund ta përhapin virusin te personat e tjerë, duke përfshirë anëtarët e moshuar të familjes.

Vaksina kundër COVID-19 është mënyra më e mirë për të mbrojtur fëmijët që të mos sëmuren shumë nga virusi.

- Vaksina gjithashtu ndihmon në mbrojtjen e fëmijëve të vegjël që nuk janë në gjendje të mbajnë maskë ose distancë sociale.
- Vaksinimi i fëmijëve gjithashtu ndihmon në mbrojtjen e personave të dashur që rrezikojnë të sëmuren rëndë nga COVID-19.

Vaksinimi ndihmon që fëmijët të mos sëmuren rëndë nga COVID-19.

- Ashtu si të rriturit, fëmijët që janë të vaksinuar mund të marrin ende COVID, por vaksinimi ka rëndësi. Ai ndihmon që ata të mos sëmuren rëndë.

Fëmijët duhet të vaksinohen ende, edhe nëse kanë pasur tashmë COVID-19.

- Personat që janë plotësisht të vaksinuar kanë mbrojtje më të mirë se njerëzit që janë infektuar vetëm me COVID-19.
- Nëse fëmija juaj ka pasur COVID, ai mund të vaksinohet sapo të shërohet nga sëmundja dhe të ketë përfunduar periudha e izolimit.

Ju duhet të vaksinoni ende fëmijën tuaj edhe nëse jeni vaksinuar gjatë shtatzënisë ose nëse jeni vaksinuar kur keni ushqyer me gji.

- Ndërsa antitrupat mund të kalojnë gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji, mbrojtja mund të zvogëlohet me kalimin e kohës.

Provat klinike kanë treguar se vaksina COVID-19 është e sigurt dhe efektive.

- Siguria e vaksinës është studiuar në mbi 10,000 fëmijë të moshës 6 muaj deri në 5 vjeç. Disa fëmijë patën efekte të lehta anësore si lodhje ose temperaturë, por kjo nuk zgjati shumë dhe të gjithë u përmirësuan shpejt.
- Vaksina e COVID-19 për fëmijët është një lloj vaksine e quajtur vaksinë mRNA, e cila është studiuar në prova të kafshëve dhe njerëzve për vite me radhë, pa efekte afatgjata.

Të gjitha vaksinat COVID i janë nënshtruar një rishikimi rigoroz përpara se të autorizohen për grupmosha specifike, përfshirë vaksinën për fëmijët më të vegjël.

- Efektet anësore të vaksinës janë zakonisht të lehta dhe të përkohshme.
- Disa fëmijë mund të përjetojnë efekte të lehta anësore si lodhje, dhimbje koke ose ethe, të ngjashme me vaksinat e tjera. Këto janë shenja që trupi po ndërton mbrojtje kundër COVID.

Vaksina kundër COVID-19 është efektive për fëmijët.

- Ashtu si të rriturit, fëmijët që janë të vaksinuar mund të marrin ende COVID, por vaksinimi ka rëndësi. Ai ndihmon që ata të mos sëmuren rëndë.

Fëmijët duhet të vaksinohen ende, edhe nëse kanë pasur tashmë COVID-19.

- Provat klinike vërtetuan se vaksina pediatrike është një mënyrë efektive për të parandaluar infeksionin COVID dhe sëmundjet e rënda tek fëmijët e vegjël.
- Provat klinike treguan se vaksina për fëmijët e vegjël është efektive në reduktimin e shkallës së infeksionit dhe në krijimin e niveleve të ngjashme të imunitetit tek fëmijët si tek adoleshentët dhe të rriturit.

Fëmijët mund të vaksinohen nga ofruesi i tyre i kujdesit shëndetësor ose në qendrat shëndetësore dhe vende të tjera që ofrojnë vaksinim për fëmijët e vegjël.

- Nëse është e mundur, kontaktoni ofruesin e kujdesit shëndetësor të fëmijës tuaj për të caktuar një takim.
- Nëse fëmija juaj nuk ka një ofrues të kujdesit shëndetësor, përdorni VaxFinder.mass.gov për të caktuar një takim në një farmaci, qendër shëndetësore ose vendndodhje tjetër që vaksinon fëmijët e vegjël.
- Vaksinimet në shtëpi janë të disponueshme për këdo që ka vështirësi në përdorimin e vendndodhjes së vaksinimit në komunitet.

Mësoni më tepër në
mass.gov/CovidVaccineYoungKids

Massachusetts Department of Public Health